



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:005900

Datë: 24.09.2018

Numri i dokumentit: 00129568

P.nr. 146/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilijana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit Q. H. nga Gjakova, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga 374/1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore - DP në Gjakovë, PP/II.nr.1809/17 të datës 20.02.2018, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **21.09.2018**, në prani të Prokurorit të shtetit Armend Zenelaj, dhe të akuzuarit Q. H., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **Q. H.**, nga Gjakova, rruga “....” – përballë “....”, i biri i G... dhe e ëma L., e gjinisë Z, data e lindjes.... në Gjakovë, ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën fillore, kamerierë, i gjendjes së dobët ekonomike, i pamartuar, shqiptar, me nr. ID

Ë s h t ë f a j t o r:

Sepse:

- **se nga data e pavërtetuar e deri me dt. 27.10.2017, rreth orës 22:20**, në shtëpinë e tij në Gjakovë rruga “....” pn – përballë “.....”, ka mbajtur në pronësi ose posedim armën në kundërshtim me nenin 4 par. 1 nën par. 1.2 dhe nenin 17 të Ligjit për Armët të Republikës së Kosovës, për të cilin me ligj kërkohet leja, dhe atë një revole pa emër të prodhuesit dhe kalibër të panjohur me nr. serik ..., së bashku me një karikator pa fishekë, në atë mënyrë që përderisa ishte pasagjer duke udhëtuar në automjetin e markës “...” me targa të regjistrimit, të cilin ishte duke e drejtuar – dëshmitari K. B. nga Gjakova, përgjatë rrugës “....” në Gjakovë, pas bastisjes nga ana e policisë në brezin e të pandehurit gjendet arma e sipër cekur dhe në gjepin e xhaketës gjendet një thikë, me ç’rast konfiskohen nga policia.

- **me çka ka kryer veprë penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së**

Andaj Gjykata në bazë të nenit 4,17,41,43,46,73 dhe nenit 374/1 të KPRK-ës, dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarit Q. H. , i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Ne shumen prej 900-€ (njëmijë e pesëqind euro), të cilin dënim është i detyruar ta paguaj në 3(tri) këste në afatin prej 3 (tre) muajve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit dhe atë kësti i parë në shume prej 300-€(treqind euro) do të paguhet deri me datën 5 të muajit të parë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, kësti i dytë prej 300-€(treqind euro) do të paguhet deri me datën 5 të muajit të dytë, kësti i tretë prej 300-€(treqind euro) do të paguhet deri me datën 5 të muajit të tretë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit .

Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë, i njëjti do të zëvendësohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 45 (katër dhjet e pesë) ditësh duke ia llogaritur 20 (njëzet) euro për një ditë burgimi .

Detyrohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguaj shpenzimet në shumë prej 30,00 €, shpenzimeve procedurale të paguaj shumën e përcaktuar nga gjykata si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20,00 € , në afat prej 15 ditëve ,pasi Aktgjykimi të marrë formë të prerë, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë .

Konform nenit 374 par.3 të KPRK-ës ,

Konfiskohet 1(një) revole pa emër të prodhuesit dhe kalibër të panjohur me nr. serik ..., së bashku me një karikator pa fishek si dhe i briskut i sekuestruar me datë 27.10.2017,si objekt i kryerjes së veprës penale pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të shkatërrohet .

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/II.nr.1809/17 të datës 20.02.2018, e ka akuzuar të akuzuarin Q. H. nga Gjakova, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontrolli ose posedimi të paautorizuar të armëve nga 374/1 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit Armend Zenelaj, gjatë shqyrtimit fillestar me dt.21.09.2018, pas leximit të aktakuzës deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës.

I akuzuari Q. H., gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë theksoi se pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe me parë pasojat e pranimin të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtoi se siç kam deklaruar edhe më herët atë e kam gjetur në një shtëpi të pabanuar dhe e njëjta nuk ka qenë funksionale, nuk ka pasur fishekë, të njëjtën nuk e kam keqpërdorur asnjëherë, i propozoj gjykatës që duke marrë parasysh rrethanat lehtësuese si pranimin e fajësisë, pendimin e shprehur për veprën e kryer, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla apo të ngjashme si dhe faktin se është hera e parë që kam rënë ndesh me ligjin, të më shqiptojë një dënim më të butë.

Prokurori i shtetit Armend Zenelaj deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi që i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe favorët juridike të pranimin të fajësisë dhe se aktakuza e ka mbështetur në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës, andaj i propozoj gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor, të dënohet sipas ligjit dhe të obligohet në

pagesën e shpenzimeve procedurale. E po ashtu, përveç revoles kërkohet që të bëhet konfiskimi i brisikut të sekuestruar me datë 27.10.2017.

Ne shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Ne tërësi u vërtetua se i akuzuari Q. H. : se nga data e pavërtetuar e deri me dt. 27.10.2017, rreth orës 22:20, në shtëpinë e tij në Gjakovë rruga “.....” pn – përballë “.....”, ka mbajtur në pronësi ose posedim armën në kundërshtim me nenin 4 par. 1 nën par. 1.2 dhe nenin 17 të Ligjit për Armët të Republikës së Kosovës, për të cilin me ligj kërkohet leja, dhe atë një revole pa emër të prodhuesit dhe kalibër të panjohur me nr. serik ..., së bashku me një karikator pa fishekë, në atë mënyrë që përderisa ishte pasagjer duke udhëtuar në automjetin e markës “Golf” me targa të regjistrimit, të cilin ishte duke e drejtuar – dëshmitari K. B. nga Gjakova, përgjatë rrugës “.....” në Gjakovë, pas bastisjes nga ana e policisë në brezin e të pandehurit gjendet arma e sipër cekur dhe në gjepin e xhaketës gjendet një thikë, me ç ‘rast konfiskohen nga policia.

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimit i fajësisë nga i akuzuari i cili ne shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë ,për shkak te se cilës gjykata nuk ka administruar provat ,gjykata ka ardhur ne përfundim se pranimit i fajësisë nga i akuzuari është bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-ës. Gjate pranimit te fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë ,pranimit është bere vullnetarisht nga i akuzuari, pranimit i fajësisë mbështetet ne faktet dhe provat qe i përmban aktakuza si: raporti i oficerit me nr. të rastit e dt. 27.10.2017, dëftesa e konfiskimit të pronës me numër dhe datë të njëjtë të rastit , evidenca e dëshmisë me numër dhe datë të njëjtë të rasti deklarata e të pandehurit dhënë në st. policor me dt. 27.10.2017 dhe në Prokurorin Themelore në Gjakovë me dt. 08.02.2018 , foto-dokumentacioni , të e prezantuar nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabime faktike .

Gjykata nga te cekurat me lartë ka ardhur ne përfundim se ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e veprës penale te përshkruara si në dispozitiv te këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur qe te akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta gjykojë ne bazë te ligjit ,me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike te tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj te akuzuarit ,gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPK-së ,të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese nuk gjeti përpos mënyrës së kryerjes së veprës penale ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit ,pranimit e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari, pendimin e tij, sjelljen korrekte në gjykim , premtimin se një veprim i tillë nuk do te përsëritet si dhe faktin se i njëjti me pare nuk ka qene i dënuar nga ana e gjykatës . Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata te akuzuarit Q. H., i shqiptojë dënimin me gjobë ne shumën prej 900,00 -€(nëntëqind euro) me bindjen e plote se ky dënim është ne harmoni me peshën e veprës penale ,shkallen e përgjegjësisë se te akuzuarit dhe se gjykata është e bindur se me dënimin e shqiptuar ndaj te akuzuarit do te arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 te KPRK-ës .

Vendimi për konfiskimin e sendit – një 1(një) revole pa emër të prodhuesit dhe kalibër të panjohur me nr. serik ..., së bashku me një karikator pa fishek si dhe i brisikut , është marr bazuar ne nenin 374/3 te KPRK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet procedurës penale n të përcaktuara nga gjykata dhe në emër të paushallit gjyqësor në shumë prej 20,00 € ,është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.6 te KPPK-së., dhe shpenzimet në shumë prej 30.00 € për kompensimin e Viktimave të Krimit numër 05/036.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr.146/18 më datë 21.09.2018.**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh** ,nga dita e marrjes se tij në dorëzim ,Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.